

Vendim nr. 52 datë 13.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahim, i,	Anëtar

në datën 13.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (F) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FREDI METO**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 9184, datë 08.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2260, datë 30.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1547 (192), datë 13.05.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare për shkak të rëndësisë së saj.**

Detyrimi i Këshillit të Ministrave për plotësimin e ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, përmes miratimit të organit shtetëror brenda afatit 1-vjeçar, sipas përcaktimeve të nenit 8 të këtij ligji.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 5, shkronja “dh”, 8 dhe 9 të ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar (*ligji nr. 7514/1991*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është njëri prej trashëgimtarëve të shtetasit N.M.M.(B)., pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të të cilit janë sekuestruar me vendimin nr. 26, datë 14.04.1948 të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Kolonjë. Me vendimin nr. 9, datë 05.05.1994 të Komisionit Trepalësh, në zbatim të nenit 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, shtetasit N.M.M. (B). i është dhënë statusi i ish-të përndjekurit politik.

2. Në bazë të pikave 2, 11, 12 dhe 16 të udhëzimit nr. 16, datë 08.08.1992 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) “*Për kriteret e kompensimit të pasurive të konfiskuara ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë që kanë fituar pafajësinë*” (udhëzimi nr. 16/1992), kërkuesi i është drejtuar Bashkisë Ersekë, në cilësinë e trashëgimtarit të ish të përndjekurit politik N.M.M. (B)., duke kërkuar vlerësimin e pasurisë së luajtshme të konfiskuar. Kjo e fundit nuk ka marrë në shqyrtim kërkesën e tij, për shkak se organi i parashikuar në udhëzimin e MFE-së nuk ekzistonte, një praktikë e tillë vlerësimi nuk ishte kryer nga asnjë organ i pushtetit vendor të qarkut të Korçës, si dhe se llojet dhe emërtimet e shumë prej mallrave të konfiskuar nuk gjendeshin ose njiheshin nga specialistët e këtij rrethi.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: “*Njohjen e së drejtës së kompensimit në lekë të pasurive të konfiskuara trashëgimlënësit tonë të ndjerit N.M.M. (B) me vendim të Gjykatës Ushtarake Korçë nr. 159, datë 05.07.1946 dhe vendimit të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit Kolonjë nr. 26, datë 14.04.1948 në masën 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë.*”, për të cilën gjykata, me vendimin nr. 9184, datë 08.10.2012, ka vendosur rrëzimin.

4. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2260, datë 30.10.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 9184, datë 08.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të lartpërmendur, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1547 (192), datë 13.05.2022 ka

vendosur prishjen e vendimeve nr. 9184, datë 08.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 2260, datë 30.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe pushimin e gjykimit.

6. Në datën 30.12.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar se i kanë cenuar të drejta kushtetuese.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

7.1. *Parimi i sigurisë juridike* në drejtim të *pritsëmërive të ligjshme*, pasi ligji nr. 7514/1991 u ka njohur familjarëve ose trashëgimtarëve të ligjshëm të ish të burgosurve politikë, që nuk jetojnë më, të drejtën për kompensim për dëmet e shkaktuara. Neni 8 i këtij ligji ngarkonte Këshillin e Ministrave për zbatimin e tij, ndërsa udhëzimi nr. 16/1992 i MFE-së parashikonte ngritjen e komisionit të vlerësimit të pasurive të konfiskuara, i cili do të bënte edhe kompensimin e tyre. Edhe pse kanë kaluar rreth 32 vjet nga miratimi i ligjit nr. 7514/1991, Këshilli i Ministrave nuk ka nxjerrë ende vendimin ose aktin normativ për krijimin e organit shtetëror përkatës, i cili do të përcaktojë kriteret e shpërblimit financiar të ish të përndjekurve politikë për pasuritë e luajtshme të marra para vitit 1990 me vendime gjyqësore ose mënyra të tjera, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e pritshmërive të ligjshme.

7.2. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi, ndonëse pranojnë se ligjvënësi nuk ka mohuar të drejtën e ish-pronarëve për sendet e luajtshme, por ka shprehur vullnetin politik dhe ligjor për t'u marrë me këtë çështje në të ardhmen, gjykatat nuk kanë marrë parasysh detyrimin e vendosur në preambulën e ligjit nr. 7514/1992 për shqyrtimin e çështjes me përparësi, duke justifikuar në këtë mënyrë këtë mangësi ligjore. Përmes vendimeve të gjykatave, Këshilli të Ministrave i është lënë një hapësirë kohore e papërcaktuar, në kundërshtim flagrant me parimin e përparësisë.

7.3. *Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*. Me vendimmarrjet e tyre, gjykatat, në veçanti Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur pushimin e çështjes, i kanë mohuar të drejtën që, deri në daljen e vendimit përkatës të Këshillit të

Ministrave, të ngrejë tjetër padi, me shkak të ndryshëm ligjor, për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

7.4. Në zbatim të nenit 124 të Kushtetutës, që përcakton fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës, si dhe të jurisprudencës kushtetuese, konkretisht vendimeve nr. 4, datë 15.02.2021 dhe nr. 30, datë 01.12.2005, Gjykata duhet të detyrojë Këshillin e Ministrave që, brenda afatit 1-vjeçar, të miratojë vendimin për krijimin e Komisionit Shtetëror për shpërblimin financiar të të përndjekurve politikë për pasuritë e paluajshme të marra padrejtësisht në periudhën post komuniste, si dhe kriteret që duhen ndjekur në këto raste.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për

mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, kërkuksi ka kundërshtuar procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1547 (192), datë 13.05.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000 kërkuksi nuk ka më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e të drejtave që pretendon se i janë cenuar, për rrjedhojë vlerësohet se ai i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion para se t’i drejtohet Gjykatës .

13. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.05.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 30.12.2022. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkuksi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin me shkresën nr. 6677/1 prot., datë 15.12.2022 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, pas kërkesës së tij të datës 09.12.2022 për dhënien informacion në lidhje me datën e arsytimit të tij. Po sipas tij, komunikimi i vendimit të Gjykatës së Lartë përmes internetit nuk parashikohet në asnjë dispozitë ligjore dhe nuk mund të pretendohet që individët kanë detyrimin e mësimit të përdorimit të internetit, aq më tepër kur bëhet fjalë për të moshuar.

14. Në lidhje me këto argumente të kërkuksit, Kolegji thekson se neni 485/b i Kodit të Procedurës Civile (KPC) “Njoftimi i vendimit të Gjykatës së Lartë” referon në nenin 316 të këtij kodi, ndërsa paragrafi 2 i këtij të fundit, në nenet 128 e vijues të KPC-së, që përcaktojnë mënyrat e njoftimit të akteve, ndër të cilat, neni 141 i KPC-së parashikon edhe atë elektronik. Bazuar në këtë dispozitë, si dhe në kompetencat e parashikuara në nenin 37 të ligjit nr. 98/2016

“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me urdhrin nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve” (urdhri nr. 131/2021), zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore të këtij institucioni për njoftimin në rrugë elektronike të palëve për të tre llojet e gjykimeve para saj, konkretisht gjykimet administrative, civile dhe penale (shih pikën 5 të këtij urdhri).

15. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi është përfaqësuar në Gjykatën e Lartë nga avokati V.P. Nga materialet e depozituara në Gjykatë së bashku me kërkesën, rezulton se në kopjet e ankimit, rekursit ose shtesave të tyre nuk është shënuar adresë elektronike e kërkuesit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Në këto kushte, sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka qenë në pamundësi të komunikimit të vendimit të arsyetuar të Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate në rrugë elektronike, në zbatim të urdhrit nr. 131/2021 të lartpërmendur. Nga ana tjetër, sipas shkresës nr. 6677/1 prot., datë 15.12.2022 të Gjykatës së Lartë, vendimi i kundërshtuar i kësaj gjykate është bërë i disponueshëm për palët në datën 07.07.2022 dhe është publikuar në faqen zyrtare në datën 15.07.2022, ndërkohë që kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 30.12.2022, pra në tejkalim të afatit 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

16. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* në kërkesën e tij sipas objektit, pasi kërkesa është paraqitur tej afatit 4-mujor të parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

17. Për sa më lart, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.